



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.32/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada- Glllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtaren e lartë ligjore, Antigona Murati duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterëve në shenjë publike të trafikut për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, kështu që koalicioni PDK-AAK-Nisma për Kosovën, dega në Gjilan i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1.600 (një mijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografimin e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 01.06.2017, në rrugën kryesore të qytetit të Gjilanit rruga Idriz Seferi, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA etj. të ngjitur në shenjë komunikacioni. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se koalicioni PDK-AAK-Nisma për Kosovën ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA, thekson se lidhur me pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe urdhërësës së PZAP-it për të ndërmarrë masa përmisuese, aktivistët e koalicionit PDK-AAK në rastin në fjalë edhe pse kanë pasur një vendim të Kuvendit Komunal në Gjilan për shfrytëzimin e objekteve publike për reklam kanë vendosur posterat në vendet në fjalë. Koalicioni PDK-AAK në përgjigjen e tyre theksuan se pas marrjes së shkresës për përgjigje është bërë menjëherë ndërhyrja dhe objektet në fjalë janë liruar nga billbordet. Për të dëshmuar këtë, përgjigjes në ankesë u janë bashkangjitur edhe provat, përgjigjen me shkrim të AAK-së në Gjilan, vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Gjilan, Formularin e Pagesës për shfrytëzimin e hapësirës dhe foton që e dëshmojnë gjendjen e tanishme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA për Kosovën etj. është vendosur në shenjë publike të trafikut, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në shenjë publike të trafikut. Pretendimet e theksuara në përgjigje në ankesë që Kuvendi Komunal në Gjilan i ka lejuar për shfrytëzim pronat publike është në kundërshtim me nenin 33.b e LZP-së ku theksohet se ndalohet

vendosja e pllakateve dhe posterëve ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut, mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë ka kryer vepra penale të kundërligjshme të parapara në ligjin e sipërcituar më lartë.

Paneli e urdhëroi koalicionin PDK-AAK-NISMA, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke e larguar menjëherë posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, është i vendosur në shenjë publike i trafikut, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të koalicionit në fjalë që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.32/2017 më datën 05.06.2017.



Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.